



Informata për vijimin e shkollës

Detyrimi shkollor

Në Gjermani të gjithë fëmijët dhe të rinjtë nga mosha 6 dhe 18 vjeçare kanë detyrim shkollor. Kjo vlenë edhe për fëmijët e refugjatëve, azilkërkuesve dhe azlkërkuesve.

Me përcaktimin dhe regjistrimin tuaj në Düsseldorf, ju si prindër, apo kujdestarë ligjorë, jeni të obliguar për të regjistruar menjëherë fëmijën tuaj në një shkollë.

Këshillimi dhe ndërmjetësimi nëpërmjet Zyrës komunale për Integrim dhe Arsim (Kommunalstelle für Integration und Bildung, KIB)

Zyra komunale për Integrim dhe Arsim (KIB) ju këshillon me rastin e zgjedhjes së një shkolle të përshtatshme për fëmijën tuaj. Në Düsseldorf në të gjitha sistemet shkollore ka një mbështetje fillestare në gjuhën gjermane për nxënës dhe të rinj me njohuri të pakëta, apo pa fare njohuri të gjuhës gjermane. Në biseda këshilluese bëhet përzgjedhja e një shkolleje të përshtatshme, mbi bazën e karrierës së deritanishme të shkollimit dhe me pjesëmarrjen e inspektorëve shkollorë.

Ju lutemi caktoni një termin këshillues tek KIB-ja nëpërmjet telefonit, duke thirrur në numrin 0211.89-2 40 63 dhe merrni me vete në termin fëmijën tuaj, si dhe dokumentet në vijim:

- Një dëshmi identifikimi, për shembull letërnjoftimin, apo pasaportën e fëmijës tuaj,
- Vërtetimin e regjistrimit nga Zyra e regjistrimit civil/Zyra civile,
- Dëftesat shkollore të fëmijës tuaj, nëse i keni.

Kontakti: Zyra për siguri sociale dhe integrim
(*Amt für soziale Sicherung und Integration*)
Zyrës komunale për Integrim dhe Arsim
(*Kommunalstelle für Integration und Bildung, KIB*)
Bertha-von-Suttner-Platz 3, 40227 Düsseldorf
Kati 8, Dhoma 8.01.
Telefoni: 0211.89-2 40 63

Oferta për qëndrime ditore

Varësisht nga ofertat e shkollave, ekziston mundësia që fëmija juaj të regjistrohet për të ashtuquajturin qëndrim ditor. Në këtë rast, fëmija juaj do të qëndronte në shkollë, pas mësimit, e merr një shujtë të ngrohtë dreke dhe për të përkujdeset personeli i ekspertëve, si dhe i ofrohet mbështetje gjatë mësimit.

Përveç kësaj ka edhe oferta të ndryshme sportive, mbështetëse dhe të kohës së lirë. Nëpërmjet kontaktit intensiv me fëmijët e tjerë, nxitet edhe më tej të mësuarit e gjuhës gjermane. Gjatë pushimeve shkollore ka oferta të tjera. Më shumë informata merrni gjatë regjistrimit të fëmijës tuaj në shkollë.

Informata të tjera

Në faqen e internetit www.duesseldorf.de/schulen janë të paraqitura të gjitha shkollat e Düsseldorf-it me lokacionin përkatës. Edhe atje për shembull gjeni informata lidhur me detyrimin shkollor.